



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_, Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

Lënda: Kthim përgjigje

Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, përcjellë me e-mailin e datës 22.04.2024, regjistruar me numër rendor 21 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve, si dhe me aktin nr. 2284 prot., datë 22.04.2024, referuar ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, bazuar në të dhënat që disponon Drejtoria e Burimeve Njerëzore, ju bëjmë me dije si më poshtë:

Lidhur me kërkesën tuaj për vënien në dispozicion të një kopje të jetëshkrimit (CV) me të dhëna deri në emërimin e fundit për subjektet ish-magjistratë të listuar në kërkesë, bashkëlidhur gjeni një kopje të jetëshkrimit, me të dhënat publike të tyre.

Gjithashtu, ju bëjmë me dije se, sa i përket ish- magjistratëve (gjyqtarë) znj. {...}, znj. {...}, z. {...}, z. {...} dhe z. {...} nuk disponojmë informacion të plotë lidhur me zhvillimin e karrierës së tyre, duke marrë në konsideratë që për këto subjekte procesi i rivlerësimit kalimtar është ndërprerë në vitin 2018 dhe në fillim të vitit 2019.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin!